



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 761/1 prot.

Tiranë, më 16.05.2022

V E N D I M

Nr. 86, Datë 16.05.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 216, datë 18.11.2021, të M.T kundër Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, (ZVAP Shkodër), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Ka punuar si mësuese e edukimit fizik në shkollën 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër. Në datë 31.08.2021 është bërë rivlerësimi i dosjes në mënyrë jo-transparente dhe është vlerësuar me 31 pikë. Për shkak se dosja nuk i është vlerësuar si duhet, duke mos i përfshirë 1 vit punë në shkollën e mesme “Oso Kuka”, ajo duhet të plotësojë ngarkesën mësimore dhe në dy shkolla të tjera, në fshatin Grudë dhe Sheldijë. Ankuesja është grua e divorcuar dhe si pasojë është shpërngulur për të banuar në Malin e Zi (Zeta), nga ku udhëton çdo ditë për të zhvilluar mësim. M.T shpjegon se e ka të pamundur që të udhëtojë çdo ditë nga Mali i Zi drejt fshatit Grudë dhe Sheldijë. Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të gjendjes arsimore, pasi ka një eksperiencë mbi 20 vjeçare dhe 20 vite punë në shkollën “Pashko Vasa” dhe vlerësimi i dosjes i është bërë në mënyrë të tillë që ti heqin orë në këtë shkollë dhe këto orë duhet ti plotësojë në shkolla të tjera”.*

¹ Për faktin se ka largësi të madhe nga vendi banimit tek vendi i punës.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rivlerësimin e dosjes.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjendjen arsimore dhe vendbanimin, të pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues (neni 1²). Neni 3, i këtij ligji, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 216, datë 18.11.2021, të bërë nga M.T, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1595/1, datë 22.11.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, ZVAP Shkodër, për ankesën e bërë, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga drejtori i shkollës “Pashko Vasa”, lidhur me ngarkesën mësimore dhe vlerësimin e dosjes së të gjithë mësuesve të edukimit fizik.
 - Kopje të vlerësimit të dosjeve dhe renditjes së mësuesve të edukimit fizik, të bërë nga ZVAP-ja, për vitin shkollor 2021-2022.

² Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

- Informacion dhe kopje të lëvizjeve paralele të mësuesve të edukimit fizik, sipas renditjes së shpallur nga ZVAP-ja.
- Kopje të ankesës së bërë nga M.T, drejtuar shkollës, ZVAP Shkodër apo DRAP Lezhë dhe përgjigjeve të dhëna nga institucionet (nëse ka).
- Informacion lidhur me pretendimin e largësisë së banimit me vendin e punës së ankueses. Si rregullohet transporti i mësuesve në fshatin Grudë dhe Sheldi?

Me shkresën nr. 4326/1, datë 03.12.2021, ZVAP Shkodër, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Punësimi i mësuesve dhe rregullimi i marrëdhënies së punës bëhet në zbatim të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’” dhe Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar. Mbështetur në Udhëzimin 12/2021, në fund të vitit shkollor është bërë vlerësimi i ngarkesës mësimore tek të gjitha institucionet arsimore nga titullaret e tyre, duke përfshirë dhe shkollën “Pashko Vasa”. Nga vlerësimi i ngarkesës mësimore ka rezultuar se ngarkesa mësimore e profilit edukim fizik në shkollën “Pashko Vasa” ishte 17 orë ndërsa mësuesit e emëruar ishin tre: M.T, A.R dhe Z.Gj. Në zbatim të Udhëzimit nr. 12/2021, drejtori i shkollës ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve (KVD) në shkollë dhe ka bërë vlerësimin e dosjeve. Pra, vlerësimi i dosjes të M.T është bërë nga drejtori i shkollës dhe jo nga ZVAP Shkodër, dhe raporti i drejtorit të shkollës ku përshkruhet e gjithë procedura e ndjekur në shkollë dhe vlerësimi i dosjeve (KVD) është përcjellë me shkresën nr. 2411, datë 31.08.2021 në ZVAP. Pretendimi i M.T se është bërë rivlerësimi i saj në mënyrë jo transparente me 31 pikë, me datë 31.08.2021, është i pasaktë, pasi në këtë datë nuk është bërë rivlerësimi dosjes së saj, por është bërë shpallja paraprake e pikëve të lëvizjes paralele për të gjithë profilet dhe të gjithë mësuesit.*

ZVAP me shkresën nr. 2419, datë 31.08.2021, ka bërë shpalljen paraprake të pikëve të lëvizjes paralele me dëshirë dhe lëvizjes paralele të detyrueshme. Pas kalimit të afatit 3-ditor për ankimim, është bërë shpallja përfundimtare e pikëve dhe theksojmë se M.T nuk ka paraqitur asnjë ankesë për pikët e dosjes. Në profilin edukim fizik kanë qenë dy mësues në lëvizjen paralele të detyrueshme dhe dy mësues në lëvizje paralele me dëshirë. M.T dhe A.R kanë qenë në lëvizje paralele të detyrueshme. Me email-in datë 06.09.2021 është bërë njoftimi për zhvillimin e procedurës së lëvizjes paralele. Ky njoftim i është bërë dhe drejtorëve të shkollave. Me datë 07.09.2021 është zhvilluar procedura e lëvizjes paralele, në të cilin i janë propozuar nga Komisioni i ZVAP vendet e lira të gjithë mësuesve të profilit përkatës në lëvizje paralele me dëshirë dhe lëvizje paralele të detyrueshme. Në lëvizjen paralele, mbështetur në kërkesat e drejtorëve të institucioneve arsimore, janë shpallur dy vende pune të lira në profilin edukim fizik:

1. Vend vakant me emërim në shkollën “Tringe Smajli” Grudë (9 orë) ku plotësohen orët në shkollën “Tonç Gjon Toma” Sheldi me 8 orë dhe shkollën “Pashko Vasa” (5 orë).
2. Vend vakant definitiv në shkollën “Mehmet Shpendi” (Theth).

Këto janë vendet e vetme që mund t'i propozoheshin M.T nga ZVAP Shkodër në zbatim të Udhëzimit nr. 12/2021. M.T, e renditur e para në lëvizjen paralele, ka pranuar para Komisionit të përbërë nga tre vetë vendin vakant me emërim definitiv në shkollën “Tringe Smajli” (9 orë) ku plotësohen orët në shkollën “Tonç Gjon Toma” me 8 orë dhe shkollën “Pashko Vasa” me 5 orë. Ndërsa mësuesi tjetër A.R, po i punësuar në shkollën “Pashko Vasa” ka pranuar vendin definitiv në Theth. Pasi ka pranuar vendin e punës, ajo është paraqitur në shkollën “Tringe Smajli” dhe ka nënshkruar kontratën, për të dhënë mësim në këto tre shkolla. Nga data e nënshkrimit të kontratës deri ditën e sotme, M.T nuk ka paraqitur asnjë ankesë me shkrim për vendin e saj të punës.

Lidhur me pretendimin për diskriminim se ka largësi të madhe nga vendi i banimit me vendin e punës sqarojmë se, largësia e banimit të M.T nga shkolla ku gjendet nuk përbën diskriminim për arsye se M.T ka vendosur vetë të banojë në një shtet tjetër, dhe ka pranuar me vullnet të lirë të punojë në pozicionin aktual. Largësia e shkollës nga qyteti i Shkodrës mbulohet përmes transportit që sigurohet nga ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë duke hequr çdo pengesë që mund të përbëjë diskriminim për mësuesit që banojnë më larg se 2 Km nga shkolla ku janë caktuar. Për mësuesit që punojnë larg vendit të tyre të banimit, mbështetur në VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” është realizuar nga DRAP Lezhë prokurimi për transportin e mësuesve dhe nxënësve. Mbështetur në linjat e miratuara të transportit të mësuesve, parashikohet dhe transporti i mësuesve për shkollën “Tring Smajli” në Grudë dhe aneksin “Sheldi”. Automjeti nisat në orën 7.30 për të dy shkollat. M.T ka parashtruar me gojë (jo me shkrim) problemin se e ka të pamundur të paraqitet në orarin e përcaktuar për transportin e mësuesve për shkollën “Sheldi”, pasi vonon për të kaluar kufirin. Argumenti nuk qëndron pasi M.T ka arritur të mbërrijë në kohë çdo ditë për të shkuar në shkollën “Tring Smajli” dhe nuk është paraqitur asnjëherë në aneksin “Sheldi”.

Në përgjigje të shkresës së ZVAP Shkodër, ankuesja me email-in datë 24.01.2022 informoi se: “Procedura e vlerësimit të dosjeve nuk ka qenë transparente, pasi është njoftuar vetëm për pikët kur janë shpallur në tabelë në këshillin pedagogjik, dhe i ka parë rastësisht, dhe pse nuk është bërë vlerësimi i dosjes në praninë e saj, pasi ajo ka eksperiencë dhe vite pune më shumë se dy mësuesit e tjerë”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke vlerësuar se bazuar në Udhëzimin 12/10.06.2021³, përcaktohet se shqyrtimi dhe vlerësimi i dosjes së mësuesve që i bie numri i ngarkesës mësimore, bëhet nga shkolla, vendosi që të përfshijë dhe shkollën “Pashko Vasa”, si subjekt për të dhënë shpjegime dhe parashtrime lidhur me çështjen.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 216, datë 18.11.2021, Komisioneri

³ “Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”.

me shkresën nr. 267, datë 07.02.2022 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 17.02.2022, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, M.T dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses me autorizim nr. 580, datë 16.02.2022, të ZVAP Shkodër, Xh.Sh, me detyrë juriste në ZVAP Shkodër dhe Drejtores së shkollës “Pashko Vasa”, Shkodër, E.R.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja në mes të tjerash deklaroi se: *“Ka 20 vite si mësuese definitive në shkollën “Pashko Vasa”. Në vitin shkollor 2019-2020 për shkak se nuk kishte ngarkesë mësimore në shkollë, ka punuar në shkollën “Oso Kuka” dhe është paguar nga shkolla “Pashko Vasa”. Në muajin shtator është paraqitur në shkollë (Pashko Vasa) kur ka parë të shpallur klasifikimin e mësuesve të edukimit fizik, në të cilën ishte klasifikuar e dyta (pa ngarkesë mësimore). Drejtoresha e shkollës e ka njoftuar për vitet e punës, pasi nuk ishin të plota në librezën e punës. Për vlerësimin e dosjes, nuk ka bërë ankim si në shkollë ashtu dhe në ZVAP Shkodër. Për arsye se është e divorcuar prej 20 vitesh jeton tek nëna e saj në Mal të Zi (afër kufirit)”*.

Gjatë seancës dëgjimore, drejtorja e shkollës “Pashko Vasa” dorëzoi dokumentacion mbi procedurën e verifikimit të ngarkesës mësimore për vitet shkollore 2019-2020 dhe 2020-2021 për shkollën “Pashko Vasa” dhe procedurën e vlerësimit të dosjeve të mësuesve që rezultojn pa ngarkesë mësimore, dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Është emëruar në pozicionin e drejtores në datë 18.03.2021 dhe që në fillim ka konstatuar se pesë mësues (dy mësues të edukimit fizik, 1 fizikë, 1 gjeografi dhe 1 gjuhë e huaj) ishin pa ngarkesë mësimore në shkollë dhe paguheshin nga shkolla, sipas një marrëveshjeje të bërë mes disa shkollave dhe ZVAP Shkodër. Në muajin qershor 2021 është bërë planifikimi i ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2021-2022. Për shkak se muaji korrik është pushim, komunikimi me mësuesit është bërë me celular, përmes një grupi të hapur në whatsapp. Është njoftuar grupi i mësuesve të shkollës që do të bëhet vlerësimi/pikëzimi i dosjeve dhe duhet të plotësonin dokumentacionin e dosjes. Është njoftuar dhe M.T se ka pasur parregullsi në librezën e punës dhe duhej të paraqitej për të numëruar vitet e punës. M.T nuk ka plotësuar dokumentacionin për vitet e punës dhe në pamundësi të kësaj, i janë numëruar 31 vite punë, aq sa ka pasur në listën e pagave të shkollës. KVD-ja është mbledhur në datë 13.07.2021 dhe përbëhej nga kryetari i bordit të prindërve, një mësuese me përvojë dhe drejtori i shkollës. Përzgjedhja e mësuesit të komisionit është bërë nëpërmjet grupit të mësuesve në whatsapp dhe nuk ka pasur kundërshtime nga asnjë mësues që do vlerësohej. Mësuesja A.M*

ka qenë anëtare e komisionit të vlerësimit të dosjeve dhe në vitin shkollor 2020-2021. Në datë 30 gusht, mësuesit kanë dalë në punë, ankuesja ka munguar dhe në datë 31 gusht është mbyllur vlerësimi dhe janë afishuar vlerësimet dhe përbërja e komisionit në Këshillin e Mësuesve. Mësuesit kanë pasur tre ditë kohë për tu ankuar për vlerësimin. M.T ka qenë në punë në datat 1, 2, dhe 3 gusht, por nuk është ankuar, as me shkrim por as me gojë”.

Përfaqësuesja e ZVAP Shkodër, në mes të tjerash deklaroi se: “ZVAP Shkodër në përfundim të informacionit të sjellë nga shkollat, bën dhe planifikimin e orëve mësimore të lira, në lëndën e edukimit fizik. Në përfundim të këtij procesi ka patur orë të lira në shkollat: Grudë, Sheldi, Theth dhe në shkollën “Pashko Vasa” (5 orë). Ankueses i janë ofruar orët e lira të cilat i ka pranuar dhe është emëruar. ZVAP Shkodër në momentin që nuk ka orë mësimore, nuk ka si ti ofrojë ankueses orë mësimore në një shkollë brenda qytetit. Këtë vit mësimor nuk është emëruar asnjë mësues i ri nga portali dhe janë bërë vetëm dy emërimet brenda sistemit: ankuesja dhe A.R”.

Në vijim të shqyrtimit të ankesës, inspektori i çështjes me e-mail-in datë 18.02.2022, drejtuar përfaqësueses së ZVAP Shkodër, Drejtores së Shkollës “Pashko Vasa” dhe ankueses ka kërkuar respektivisht informacion dhe dokumentacionin si më poshtë:

ZVAP Shkodër:

- A janë njoftuar mësuesit që do ti nënshtroheshin lëvizjes paralele, për të kontrolluar dhe plotësuar dosjet personale, nga ana e ZVAP Shkodër.
- Kopje të kontratës së punës së mësueses M.T dhe Z.Gj.

Shkollës “Pashko Vasa”:

- Si është bërë procesi i përzgjedhjes së përfaqësuesit të mësuesve në komisionin e vlerësimit të dosjeve.
- A ka pasur ankesa nga mësuesit e tjerë për përbërjen e komisionit të vlerësimit të dosjeve.
- Prova për njoftimin e mësuesve për plotësimin e dosjes me dokumentacion dhe në veçanti njoftimin për mësuesen M.T.
- Si është bërë vlerësimi i vjetërsisë në punë të mësueses M.T.
- Kopje të dosjes personale të mësueses, Z.Gj.

Subjektit ankues:

- Shkakun për të cilin pretendon diskriminim nga ZVAP Shkodër.
- Kopje të kallëzimit penal të bërë në Prokurorinë Shkodër.
- Kopje të certifikatës personale.
- Shpjegime të detajuara për vjetërsinë në punë.

Në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, ZVAP Shkodër me e-mail-in datë 29.03.2022 dhe 14.04.2022, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi

Komisionerin se: “Procedura e lëvizjes paralele për vitin shkollor 2021-2022 është zhvilluar në zbatim të plotë të Udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”. Udhëzimi 12/2021, në Kreun VII, pika 1 përcakton se: “Në përfundim të vitit shkollor procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga ZVAP-ja, vetëm për mësues që ushtrojnë profesionin e mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare, brenda juridiksionit të ZVAP-së, sipas listës së aplikimeve të vlerësuara në periudhën e përcaktuar në udhëzim”. Udhëzimi 12/2021, në kreun VII, pika 14 përcakton se: “Mësuesi, i cili është në marrëdhënie pune dhe dëshiron të kryejë lëvizje paralele gjatë vitit shkollor, duhet të regjistrohet online në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe t’u nënshtrohet të dy fazave të konkurrimit, sipas dispozitave të krerëve 2, 4 dhe 8, të këtij udhëzimi, si dhe ruan vendin e punës pavarësisht rezultatit të arritur”.

Aktualisht gjendemi në mes të vitit shkollor dhe M.T nuk mund t’i propozohet asnjë vend pune, pasi këto vende shpallen në portal. Gjatë lëvizjes paralele që do të zhvillohet pas përfundimit të vitit shkollor, propozimi i vendeve të lira të punës do të bëhet duke respektuar renditjen”.

Shkolla “Pashko Vasa” me shkresën nr. 553/1, datë 08.03.2022, dërgoi kopje të dokumentacionit të kërkuar dhe informoi se: “Përzgjedhja e përfaqësuesit të mësuesve për komisionin e vlerësimit të dosjeve (KVD) është bërë nëpërmjet grupit të mësuesve në whatsapp, për arsye se nevoja e KVD-së lindi pas rakordimit të ngarkesës mësimore në ZVAP Shkodër, me datë 01.07.2021, datë kur mësuesit kishin filluar pushimet verore. Bazuar në Kontratën Kolektive të Punës, nr. 6145, datë 05.06.2018, neni 8 “Koha e Pushimit”, pika 8.3 citohet ndër të tjera se: “Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të jetë më pak se 45 ditë kalendarike dhe nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë”. Për këtë është ngritur një Urdhër i brendshëm nr. 502/2, datë 06.07.2021, për përzgjedhjen e mësuesit në KVD, nëpërmjet grupit të shkollës në whatsapp. Pas telefonatave të mësuesve dhe përzgjedhjes së mësuesit, emri është publikuar në grupin e mësuesve. Nuk ka patur asnjë ankesë për mësuesin në KVD as në grup, as me shkresë. Theksoj se mësuesi i përzgjedhur është i njëjti mësues i një viti më parë në KVD. Janë njoftuar mësuesit dhe për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve, bashkëlidhur bisedat që e vërtetojnë që janë lajmëruar. Meqënëse mësuesja M.T kishte mangësi në librezën e punës, pasi ka sjellë pak fletë të fotokopjuara, gjithashtu dhe mësuesi A.R, nuk kishte libeze pune të plotësuar, ne si komision ramë dakort që vitet e punës, të 3 mësuesve të edukimit fizik të nxirreshin bazuar në listëprezencën e shkollës, e cila përmban vjetërsinë në punë të secilit mësues”.

Në vijim ankuesja me e-mail-in datë 28.02.2022 dhe 06.04.2022, dërgoi të njëjtat parashtime dhe shpjegime të bëra të njohura gjatë seancës dëgjimore, si dhe dërgoi kopje të certifikatës personale dhe të përgjigjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, datë 06.04.2022.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi’*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre’*”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij’*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjendjen arsimore apo në vendbanim, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

Procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune për vitin shkollor 2020-2021 janë parashikuar sipas Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar.

Procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune për vitin shkollor 2021-2022 janë parashikuar sipas Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë *“Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”*.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar Librezës së Punës nr. 163, datë 15.06.1998, të M.T, rezulton se ka filluar punë si mësuese në shkollën “Pashko Vasa”, në datë 15.06.2005.

Në datë 30.06.2020, në përfundim të vitit shkollor 2019-2020, për shkak të rënies së ngarkesës mësimore, Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve (KVD), të shkollës “Pashko Vasa”, i cili përbëhej nga Drejtori i shkollës D.G, anëtari Sh.Gj dhe mësuesja A.M, kanë bërë vlerësimin e dosjeve të mësuesve, lëndët e të cilëve rezultonin pa ngarkesë mësimore, bazuar në kriteret e vlerësimit sipas Udhëzimit Nr. 13, datë 22.05.2019, *“Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’*”, i ndryshuar.

Këtij vlerësimi i janë nënshtruar 12 mësues, në mes të cilëve dhe tre mësuesit e lëndës edukim fizik: M.T, Z.Gj dhe A.R. Referuar tabelës së vlerësimit rezulton se: Z.Gj është vlerësuar me 18.5 pikë, M.T është vlerësuar me 13.5 pikë dhe A.R është vlerësuar me 12.5 pikë.

Shkolla “Pashko Vasa” me shkresën nr. 443/6, datë 13.07.2020, drejtuar ZVAP Shkodër ka dërguar listën emërore të mësuesve që rezultonin pa ngarkesë mësimore për vitin shkollor 2020-2021. Ndër mësuesit e kësaj liste rezultojnë dhe mësuesit e edukimit fizik: M.T dhe A.R.

Me shkresën nr. 456, datë 14.09.2020 “Marrëveshje për plotësim orësh” të firmosur mes shkollës “Pashko Vasa”, “Oso Kuka” dhe ZVAP Shkodër, M.T është caktuar si mësuese pranë shkollës “Oso Kuka” deri në përfundim të vitit shkollor.

Shkolla “Pashko Vasa” me shkresën nr. 502, datë 01.07.2021, ka urdhëruar që brenda datës 15.07.2021 të bëhet parashikimi i ngarkesës mësimore, numri i punonjësve arsimorë si dhe numri i nxënësve për klasë për vitin mësimor 2021-2022, sipas parashikimeve të pikës 5, Kreu 7 i Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021⁴.

Në Kreu 7, pika 10 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 *“Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’*”, përcaktohet se: *“Kur në një institucion arsimor bie numri i ngarkesës mësimore për një profil/lëndë, drejtori i IAP-së krijon komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve të atij profili/lënde”*. Ndërsa në pikën 11, përcaktohet përbërja e Komisionit për shqyrtimin e dosjeve: *“Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë përbëhet nga drejtori i shkollës (kryetar), një mësues i atij*

⁴ *“Për mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, drejtori i IAP-së dërgon në ZVAP listën emërore, dokumentacionin e njësuar me origjinalin dhe vlerësimin e dosjeve, sipas shtojcës 2.1 të këtij Udhëzimi, brenda datës 15 Korrik”*.

institucioni arsimor parauniversitar që vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në profesion (anëtar) dhe kryetari i këshillit të prindërve të po atij institucioni arsimor parauniversitar (anëtar). Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në institucionin arsimor parauniversitar ka për detyrë të bëjë vetëm vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit/lëndës, për të cilën bie numri i orëve sipas shtojcës 2.1 të këtij Udhëzimi, dhe të publikojë në mjediset e institucionin rezultatet me ID-të përkatëse”.

Në zbatim të udhëzimit të mësipërm, drejtorja e shkollës “Pashko Vasa”, ka informuar mësuesit e shkollës, nëpërmjet grupit të mësuesve në whatsapp, se njëri nga tre mësuesit që nuk do i vlerësoheshin dosjet dhe që ka performancën më të mirë, do të zgjidhej pjesë e KVD-së. Referuar mesazheve të mësuesve, rezulton se mësuesit kanë përzgjedhur mësuesen A.M që të ishte pjesë e KVD-së. Gjithashtu, referuar komunikimit të grupit të mësuesve në whatsapp, rezulton se në datë 08.07.2021, drejtorja e shkollës ka lajmëruar mësuesit se: *“Nëse keni dokumentacion të paplotësuar në dosjet tuaja në shkollë, apo të panoterizuara, keni afat deri të hënën datë 11.07.2021 për t’i plotësuar që të mërrni pikët e merituar e mos të penalizoheni..”* dhe *“pas parashikimit të ngarkesës mësimore dhe numrit të nxënësve për klasë, ju bëj me dije se në profilet gjuhë shqipe, gjuhë e huaj, histori-gjeografi, edukim fizik, arsim fillor dhe matematikë-fizikë si profil i përafërt do të bëhet pikëzimi i dosjeve për lëvizje paralele të detyrueshme”.*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ankuesja ka qenë pjesë e grupit të komunikimit dhe është njoftuar për plotësimin e dosjes dhe se do të vlerësohej nga komisioni.

Shkolla “Pashko Vasa” me shkresën nr. 503, datë 08.07.2021, ka urdhëruar:

1. Të krijohet KVD-ja për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve për mësuesit të cilët rezultojnë pa ngarkesë mësimore për vitet 2021-2022, në profilet: gjuhë shqipe, gjuhë e huaj (anglisht), histori-gjeografi, arsim fillor, edukim fizik, gjithashtu dhe vlerësimi i dosjes së profilit matematikë-fizikë.
2. Komisioni të përbëhet nga: Drejtori i shkollës, mësues me arritje të larta profesionale, A.M dhe Kryetari i Këshillit të Prindërve K.N.

Drejtorja e shkollës “PashkoVasa”, në datë 13.07.2021 ka mbledhur KVD-në dhe ka bërë vlerësimin me sistem pikëzimi, sipas parashikimit të shtojcës 2.1 të Udhëzimit 12/2021, për të gjithë mësuesit që do kishin lëvizje paralele, sipas tabelës më poshtë:

Emri	Profili	Pikët. Nota mesatare	Kateg. kualifikimit	Dëshmi.Gjuhë e huaj	Trajnime kredite	Vitet e punës	Vlerësimi prindërve	Vlerësimi i Psikologut	Vlerësimi drejtorit	Shuma pikëve
O.A	Ang									
D.M	Ang									
M.T	Ed.fizik	0.5	8	0	3	15.5	0	2	2	31
Z.Gj	Ed.fizik	2.5	6	0	3	14	2	2	2	31.5
A.R	Ed.fizik	2.5	0	0	3	1.5	0	2	2	11

A.L	Mat-Fiz									
L.L	Fizikë									

Referuar sistemit të vlerësimit sipas udhëzimit të sipërcituar, komponenti i viteve të punës vlerësohet 0.5 pikë për çdo vit pune.

Referuar vlerësimit të KVD-së, rezulton se komisioni ka vlerësuar 31 vite punë të M.T me 15.5 pikë.

Referuar deklaratës së bërë gjatë seancës dëgjimore, ankuesja në datë 1 shtator 2021 ka dalë në shkollë dhe ka marrë dijeni mbi vlerësimin me pikë të dosjes së saj, e cila rezultonte e renditur e dyta në profilin e mësuesve të edukimit fizik, pra pa ngarkesë të plotë mësimore në shkollën “Pashko Vasa”.

Në analizë të informacionit dhe provave të administruara, rezulton se librezja e punës së ankueses, është e pasaktë dhe ka mbivendosje të viteve të punës. Ankuesja nuk ka arritur që të deklarojë saktë, si tek punëdhënësi ashtu dhe tek Komisioneri vjetërsinë në punë.

Në këto kushte, për të vlerësuar vjetërsinë në punë të ankueses, do ti referohemi listë prezencës së muajit shtator 2021, të shkollës “Pashko Vasa”. Referuar kësaj listë prezence rezulton se M.T ka 31 vite vjetësi në punë, Z.Gj ka 28 vite dhe A.R ka 3 vite vjetësi në punë. Pra, për të tre mësuesit e profilit edukim fizik është bërë vlerësimi i vjetërsisë në punë në mënyrë të barabartë, sipas udhëzimit të sipërcituar. M.T është vlerësuar me 31 vite punë/15.5 pikë, Z.Gj është vlerësuar me 28 vite punë/14 pikë dhe A.R është vlerësuar me 3 vite punë/1.5 pikë.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, Komisioneri vlerëson se, ankuesja nuk ka arritur të provojë vjetërsinë në punë, as para KVD-së dhe as para Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pretendimi i ankueses se nuk i janë numëruar të sakta vitet e punës, nuk është i mbështetur në dokumentacion, por ngelet në kuadër të deklarimeve dhe e pambështetur në prova.

Në Kreu 11, pika 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, përcaktohet se: “1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionet e mësuesit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. 2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi, menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë-pune pas shpalljes së tyre”.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se M.T, nuk ka ankimuar vlerësimin e dosjes të bërë nga KVD-ja e shkollës “Pashko Vasa”.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ZVAP Shkodër dhe shkolla “Pashko Vasa”, rezulton se nga ana e shkollës “Pashko Vasa” është ndjekur e njëjta procedurë dhe është mbajtur i njëjti qëndrim gjatë procesit të vlerësimit të dosjeve, për të gjithë mësuesit që rezultonin pa ngarkesë

mësimore, në përfundim të vitit shkollor. Referuar komunikimeve të grupit të mësuesve, rezulton se drejtorja e shkollës ka njoftuar të gjithë mësuesit që duhet të plotësonin dosjet për ndonjë mangësi të mundshme, si dhe ka njoftuar në veçanti ankuesen për saktësimin e viteve të punës, dhe në përfundim i janë referuar listë pagesës së shkollës për të përcaktuar pikët për vjetërsinë në punë.

Në Kreun 1, pika 7 të Udhëzimit nr. 12, date 10.06.2021 *“Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, përcaktohet se: “Vendet e lira të punës në përfundim të vitit shkollor, shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe pasi janë sistemuar mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar deri në 1 (një) muaj para fillimit të vitit mësimor”.*

Ndërsa në Kreun 8, pika 2 dhe 3 të Udhëzimit të sipërcituar, parashikohet se: *“2. Vendet e lira të punës, të paplotësuara në përfundim të vitit shkollor u ofrohen në fillim mësuesve nga lista për lëvizje paralele brenda ZVAP, sipas renditjes. 3. Për një vend të lirë pune, kandidati njoftohet nga ZVAP-ja përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online”.*

Në zbatim të parashikimeve të mësipërme, ankuesja me e-mail-in datë 06.09.2021, të dërguar nga ZVAP Shkodër, është njoftuar për t’u paraqitur në ZVAP në datë 07.09.2021, për të parë mundësinë e përzgjedhjes së vendit të punës në profilin e saj.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ZVAP Shkodër, për lëvizjen paralele të mësuesve të profilit, edukimit fizik mbështetur në kërkesat e drejtorëve të institucioneve arsimore, ka shpallur dy vende pune të lira: 1 (një) vend vakant me emërim në shkollën “Tringe Smajli” Grudë (9 orë) ku plotësohen orët në shkollën “Tonç Gjon Toma” Sheldi me 8 orë dhe shkollën “Pashko Vasa” (5 orë), dhe 1 (një) vend vakant definitiv në shkollën “Mehmet Shpendi” (Theth).

Referuar deklaratës nr. 2536/1, datë 07.09.2021, të mbajtur në mjediset e ZVAP Shkodër, rezulton se ankuesja ka pranuar të punësohet pa afat, në pozicionin si mësuese në profilin edukim fizik, në shkollat: “Tringe Smajlaj”, “Tonç Gjon Toma” dhe “Pashko Vasa” dhe mësuesi i renditur i dyti, A.R ka pranuar pozicionin në shkollën Theth.

Me Vendimin nr. 4, datë 23.09.2021, M.T është emëruar si mësuese me kontratë pune pa afat në shkollën “Tringe Smajli” Grudë e Re dhe po atë datë është lidhur dhe kontrata individuale e punës me afat të përcaktuar, me nr. 39, datë 23.09.2021.

Pra, nga informacioni i sipërcituar, rezulton se ankueses i janë ofruar vende të lira pune me afat nga ana e ZVAP Shkodër dhe institucionet arsimore nën juridiksionin e saj. Në momentin që ajo ka rënë dakord për një nga pozicionet e ofruara më sipër, si në rastin e shkollës “Tringe Smajlaj”, ka pranuar pozicionin e punës dhe ka vijuar të zhvillojë mësimin në profilin e edukimit fizik pranë këtij institucioni arsimor.

Gjithashtu, nga informacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton se ka pasur vende të lira pune, për mësues të profilit edukim fizik, në ndonjë shkollë tjetër të ZVAP-së Shkodër, në mënyrë që ankuesja të kishte mundësi që të emërohej në një shkollë brenda qytetit ose në afërsi të tij.

Në pikën 1/a të VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, përcaktohet se: “Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e: a) punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore publike të cilët punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, në largësinë mbi 5 km nga kufiri i njësisë përbërëse administrative të vendbanimit të tyre të përhershëm, dhe kthehen brenda ditës”.

Referuar certifikatës personale të M.T, rezulton se ajo është banore e qytetit të Shkodrës. Referuar shkresës nr. 7620/1, datë 27.05.2021 të Bashkisë Shkodër, rezulton se mjeti i transportit për në shkollat: “Tonç Gjon Toma” dhe “Tringe Smajli” nisen nga qyteti i Shkodrës, në orën 07.30.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e shkollës “Pashko Vasa”, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe kriteret, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për vlerësimin e dosjes së ankueses, dhe M.T ka pasur mundësinë për të plotësuar dosjen ose për t’u ankuar për vlerësimin e pasaktë të vjetërsisë në punë.
- Ankuesja nuk është vendosur në asnjë moment në kushte të pafavorshme nga ana e drejtorisë së shkollës “Pashko Vasa”, pasi KVD-ja e shkollës, ka mbajtur të njëjtin qëndrim për vlerësimin e vjetërsisë në punë dhe për mësuesit e tjerë të profilit edukim fizik.
- Nuk rezultoi se në ZVAP Shkodër, të kishte pozicione të lira të profilit edukim fizik në ndonjë shkollë tjetër dhe të mos i ishte ofruar ankueses.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se ZVAP Shkodër dhe shkolla “Pashko Vasa”, nuk kanë ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e ZVAP Shkodër dhe shkollës “Pashko Vasa”, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se ZVAP Shkodër dhe shkolla “Pashko Vasa” kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuseses M.T, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër dhe shkollës “Pashko Vasa”, për shkaqet e pretenduara prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA